



REPUB LIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

TERMAT E REFERENCËS DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE
PËR
HARTIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT, PËR EKONOMINË PYJORE
“**Polis-Vasjan**”, BASHKIA **ELBASAN**.

PËRMBAJTJA

Bazuar në Urdhërin Administrativ nr. _____, datë ___/8/2023; të titullarit të entit prokurues, Bashkia Elbasan “Për hartimin e termave të referencës, specifikimeve teknike, përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, kërkesave për kualifikimqë lidhen me kapacitetin teknik dhe kriteret për shpalljen e ofertës fituese për procedurën me objekt: Hartim plani mbarështimi në pyje dhe kullota, për ekonominë pyjore Polis Vasjan, në atributin e specialistit (Inxhinier) të Pyjeve/Kullotave pranë Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar për kryerje e këtij shërbimi sipas këtij urdhëri, kam përgatitur materialin sipas përmbajtjes poshtshënuar:

| | |
|--|----|
| 1. TË PËRGJITHSHME..... | 3 |
| 1.1 Ekonomia Pyjore “ Polis-Vasjan ” | 4 |
| 2. TERMAT E REFERENCËS PËR HARTIMIN PMPK..... | 5 |
| 2.1 Detyrat që ndiqen për hartimin e Planit të Mbarështimit..... | 5 |
| 2.2 Objektivat e përgjithshme dhe specifike të Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave..... | 6 |
| 2.3. Qëllimi i Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave..... | 7 |
| 2.4. Fazat që ndiqen për hartimin e Planit të Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore..... | 7 |
| 2.5 Përmbajtja e Planit të Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore..... | 8 |
| 2.6. Përgatitja e hartave..... | 11 |
| 3. AFATI I HARTIMIT TË PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE.... | 12 |
| 4. MONITORIMI I FAZAVE TË HARTIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT..... | 15 |
| 5. MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT..... | 15 |
| 6. REFERENCA LIGJORE..... | 16 |
| 7. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT..... | 16 |
| 8. FONDI LIMIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT..... | 18 |

1. TË PËRGJITHËSHME

Plani i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave (më poshtë PMPK) është një dokument bazë për mbarështimin e pyjeve dhe kullotave i hartuar sipas ekonomive pyjore, me punime terreni e zyre, për njohjen dhe marrjen e një sër të dhënash për tokën, klimën, faunën, biodiversitetin, grumbullin pyjor etj, si dhe masat që parashikohen për administrimin dhe qeverisjen e qëndrueshme të fondit pyjor, organizimin e prodhimit dhe planifikimin e punimeve të ndërthurura, të nevojshme për t'u implementuar në këtë ekonomi pyjore, për një afat kohor të përcaktuar (10 vjet).

Planifikimi afatgjatë i qeverisjes së pyjeve dhe kullotave për një periudhë **10 vjeçare** duhet të mbulojë të gjitha aspektet sociale, ekologjike dhe ekonomike.

Në kuadër të reformës administrativo-territoriale, të ndërmarrë vitet e fundit, Bashkisë **Elbasan**, nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar, janë transferuar dhe kanë kaluar në pronësi sipërfaqet e fondit pyjor e kullor në territorin e kësaj bashkie.

Nga 15 ekonomi pyjore që përfshihet fondi pyjor e kullor i Bashkisë Elbasan, nga këto 6 ekonomi pyjore kanë Plane Mbarështimi (të hartuara në vitet e fundit), ndërsa të gjithë të tjerat kanë vetëm Plane Inventarizimi të hartuara qysh në vitin 1985 dhe për pasojë afati kohor i vlefshmërisë së tyre ka skaduar. Duke patur parasysh se gjatë këtyre viteve në këto ekonomi pyjore kanë ndodhur ndryshime të mëdha në cilësi dhe sasi, të cilat kanë ardhur si rezultat i shfrytëzimeve të lëndës drusore, ndërhyrjeve të paligjshme, dëmtimet nga rënia e zjarreve, zënia e sipërfaqeve pyjore me anë të shpyllëzimeve (kthimi i tyre në vreshta, apo pemtari), ndryshimet në sipërfaqe dhe volum etj..., të cilat nuk janë pasqyruar në mënyrë të saktë në regjistrat kadastral të fondit pyjor e kullor ndër vite (në zona të veçanta edhe nuk janë raportuar fare) e për pasojë është krijuar një kakofoni në inventarin e këtij fondi dhe aq më teper në planifikimin e aktiviteteve në shërbim të pyllit dhe komuniteteve lokale.

Së fundmi duhet të theksohet fakti se mbështetur në ligjin 57/2020 “Për pyjet” i sanksionon detyrimin e Njësive të Qeverisjes Vendore (Bashkitë) për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave. Gjithashtu ç’do ndërhyrje në fondin pyjor/kullor duhet të bazohet tek rekomandimet e planeve të mbarështimit, brenda afatit të vlefshmërisë së tijë (10vjet).

Më poshtë po japim një përshkrim të shkurtër të ekonomisë pyjore që ne propozojmë të kryejmë planin e mbarështimit.

1.1 Ekonomia Pyjore “Polis-Vasjan”

Në ekonominë pyjore “**Polis-Vasjan**”, Plani i fundit i Mbarështimit (Inventarizimit) është hartuar në vitin 1985 dhe gjatë kësaj kohe ka pësuar ndryshime të mëdha të vazhdueshme. Ajo shtrihet në Njësitë Administrative **Shushicë**, e cila ndodhet në Jug-Lindje të Bashkisë Elbasan në një distancë mesatare rreth 8 km nga qendra e bashkisë. Të gjitha ujërat e këtij pellgu ujmlëdhës mbliidhen në disa përrenj si ai i Gostimës, Gurrës, Shathatës etj të cilët prurjet e tyre i derdhin në Lumin Shkumbin.

Kuota më e vogël e kësaj ekonomie është 142 m në kufij me ekonominë pyjore “Zalli Shkumbin” dhe kuota më e lartë 1385 m (maja e Munellës), në kufi me ekonominë pyjore “Shpat-2”. Kjo ekonomi pyjore kufizohet me fondin pyjor të Bashkisë Librazhd në Lindje të sajë (prroi i Gostimës). Terreni është kryesisht malor e kodrinor ku përshkohet nga prroska të shumta me shfaqje të theksuara të erozionit sipërfaqësor, kryesisht në anën Jug-Lindore dhe Lindore të sajë.

Në këtë ekonomi pyjore mbizotërojnë trungishtet me llojet pyjore si: Ah, Pisha e egër, Pishë e zezë, ndërsa cungishtet dominohen kryesisht nga dushkajat (Bunga, Bungebuta, Qarri) ndërsa shkurret janë në sipërfaqe të konsiderueshme që kryesisht përbëhen nga Shkoza, Mrete, Frashër, cermedell dhe pak Dëllinjë e kuqe.

Në pasqyrën e mëposhtme, jepen të dhënat e ekonomisë pyjore sipas formës së përdorimit dhe qeverisjes të territorit të sipërfaqes që zënë, sipas zërave kadastral:

| <i>Ekonomia Pyjore</i> | <i>Përdorimi i Teritorit</i> | | <i>Sipërfaqja në (Ha)</i> |
|------------------------|----------------------------------|---------------|---------------------------|
| "Polis-Vasjan" | Pyll | Trungishte | 803,2 |
| | | Cungishte | 1100 |
| | | Shkurre | 1164 |
| | | Totali | 3067,2 |
| | Kullota, livadhe | | 595 |
| | Inproduktive | | 360,8 |
| | Tokë me bimësi pyjore | | 437,2 |
| | Djerr | | 0,0 |
| | Ujore | | 0,0 |
| | Totali i ekonomisë pyjore | | |

2. TERMAT E REFERENCËS PËR HARTIMIN PMPK

Termet e referencës me të gjithë elementët përbërës janë hartuar dhe mbështetur në Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr.864 prot, datë 30.01.2019 si dhe në eksperiencën e deritanishme të hartimit të planeve të mbarështrimit, që ka përfunduar Bashkia Elbasan.

Manuali përcakton në mënyrë të detajuar kërkesat që duhet të plotësojë subjekti i kontraktuar gjatë fazës së punimeve të terrenit dhe ato të përpunimit të dhënave më pas në zyrë.

Keto terma reference do të shërbejnë për të përcaktuar përgjegjësitë, detyrat dhe kualifikimet e kërkuara për konsulentët që do të hartojnë Planin e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave për këtë ekonomi pyjore të Bashkisë **Elbasan**, bazuar në Udhëzuesin e lartëpërmendur dhe eksperiencën e deritanishme lidhur me këtë fushë.

2.1 Detyrat që ndiqen për hartimin e Planit të Mbarështimit

Detyrat që duhet të zbatojë subjekti i kontraktuar me qëllim hartimin e Planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave do të jenë:

- Grumbullimi dhe shqyrtimi i literaturës për të vlerësuar gjendjen aktuale të burimeve pyjore/kullosore në ekonominë pyjore.
- Përshkrimi i përgjithshëm në terren i parcelave e n/parcelaveve, verifikimi i kufijve, përcaktimi definitiv në terren duke shënjuar me bojë vaji kufijtë e tyre, hedhja e ndryshimeve në hartë dhe llogaritja e sipërfaqeve përkatëse.
- Vlerësimi i sipërfaqes dhe volumit të pyjeve sipas formave të ndryshme të qeverisjes:
 - Trungishte
 - Cungishte
 - Shkurre
- Vlerësimi kullotave/livadhe, përfshirë kapacitetin prodhues të tyre si dhe atë mbajtës.
- Vlerësimin e llojshmërisë dhe sasisë së prodhimeve jo-pyjore (prodhimeve të dyta).
- Identifikimi i problematikës lidhur me aspektet menaxhuese të pyjeve.
- Identifikimi i çështjeve kyçe që kanë të bëjnë me aspektet ligjore, administrative dhe ato të menaxhimit, faktorët dhe aktorët që influencojnë.
- Identifikimi i zgjidhjeve sociale bazuar në potencialet ekologjike të zonës.
- Eksplorimi dhe propozimi i alternativave më të mira të menaxhimit të bazuara dhe të integruara në nevojat e ruajtjes dhe zhvillimit të fondit pyjor dhe të komunitetit.
- Hartografimi i territorit të zonës (në GIS), duke përfshirë:
 - Ekonominë pyjore, ndarjen e parcelave e të n/parcelave, llojet pyjore dhe format e qeverisjes/

- Përdorimin e territorit të zonës.
- Masat e propozuara të parashikuara për përmirësimin dhe trajtimin e pyjeve.
- Rrjetin e përhershëm dhe të përkohshëm të sipërfaqeve provë.
- Ngritjen e një sistemi të përhershëm dhe përkohshëm sipërfaqesh provë për matjen (dhe më tej monitorimin periodik) dhe llogaritjen e volumit të pyjeve, bazuar në udhëzuesin përkatës të hartimit të Planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave.
- Marrja e profileve të tokës për çdo tip toke dhe kategori thellësi.
- Zhvillimi i një vizioni, misioni dhe objektivi kryesor të menaxhimit për ekonominë pyjore.
- Hartimi i strategjive të duhura të menaxhimit, si dhe planit të veprimit.
- Plani i monitorimit të menaxhimit dhe aktiviteteve që priten të zhvillohen në zonë.
- Hedhja e të dhënave të grumbulluara në terren dhe përpunimi kompjuterik i tyre.
- Diskutimi dhe konsultimi i aktiviteteve kryesore të planifikimit dhe zbatimit të planit të mbarështimit me palët e interesuara.
- Konsultimi i draft-planit të menaxhimit me aktorët vendimarrës (Bashkia **Elbasan**, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësitë Administrative, banorët, shoqatat etj).
- Recensime të draft-planit të përgatitur.
- Ripunim material pas vërejtjeve të bëra.

2.2 Objektivat e përgjithshme dhe specifike të Planit të Mbarështimit të P.K

Objektivi i përgjithshëm i Planit të Mbarështimit duhet të jetë menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore/kullosore në pronësi të Bashkisë Elbasan (edhe nga këndvështrimi ekologjik), me strukturë dhe cilësi të mirë në përshtatje me kushtet e zonës dhe në përputhje me objektivat e mbarështimit.

Objektivat specifike të Planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, duhet të jenë:

- Përcaktimi i përdorimit të territorit në përputhje me gjendjen aktuale dhe nevojat.
- Optimizimi i formës së qeverisjes në përputhje me nevojat lokale, mundësitë e grumbullit pyjor dhe mjedisit për të përmirësuar prodhimtarinë.
- Optimizimi i funksioneve ndërmjet nevojave dhe mundësive ekologjike/silvikulturale në përputhje me rëndësinë multifunksionale, sociale dhe mjedisore të pyjeve.
- Përmirësimi dhe mirëmbajtja në një gjendje të mirë funksionale të grumbujve pyjor.
- Rritja e prodhimtarisë së pyjeve me funksion prodhues.
- Përmirësimi i cilësisë dhe gjendjes së grumbujve të trungishteve me funksion prodhues.
- Nxitja dhe përdorimi i ripërtëritjes natyrore sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim që të krijohen ekosisteme pyjore që i përshtaten mjedisit.
- Pakësimi i impakteve negative në gjendjen fitosanitare të pyjeve dhe prerjeve të paligjshme.

- Rehabilitimi dhe garantimi i rritjes së qëndrueshme të prodhimtarisë në sipërfaqet pyjore/kullosore.
- Sigurimi i pjesëmarrjes së gjërë të **aktoreve** lokale në marjen e vendimit për menaxhimin e pyjeve/kullotave.
- Përmirësimi i menaxhimit të pyjeve duke lidhur resurset pyjore/kullosore me interesat e përdoruesve.
- Menaxhimi i punës për hartimin e planit dhe futjen e të dhënave në SISP
-

2.3. Qëllimi i hartimit të Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave

Hartimi i PMPK duhet të bëhet bazuar në parimin e mbarështimit të qëndrueshëm që nënkupton "të ruajë dhe të forcojë gjendjen shëndetsore të ekosistemeve pyjore për një afat kohe të gjatë dhe në të njëjtën kohë për të siguruar mundësi ekologjike, sociale, ekonomike dhe kulturore për mirëqenien e brezave aktuale dhe atyre të ardhshëm". Ky plan hartohet për ekonominë pyjore që është pjesë e e territorit administrativ të Bashkisë **Elbasan** dhe natyrisht në kordinim edhe me njësitë e tjera administrative fqinje apo zonat e mbrojtura nëse është e nevojshme.

Hartimi i Planit të Mbarështimit është një mjet për të njohur gjendjen aktuale të territorit, siguron një ndëveprim me aktoret dhe Bashkinë si dhe kordinim me institucionet qendrore nëpërmjet përdorimit të SISP dhe kjo duhet të ndodhë gjatë hartimit të PMPK dhe gjatë drejtimit të ndërhyrjeve dhe ngjarjeve në periudhën e vlefshmërisë së planit.

2.4. Fazat që ndiqen, për hartimin e Planit të Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore

Sipas Udhëzuesit në fuqi, procesi i hartimit të PMPK duhet të ndjekë këto faza:

- a) Puna përgatitore (Mbledhja informacionit, trainimi, prezantimi, sensibilizimi i komuniteteve lokale etj)
- b) Puna në terren (matja dhe mbledhja e të gjithë të dhënave të terrenit)
- c) Puna në zyrë (përpunimi, interpretimi, sistemimi, shkrimi etj)
- d) Miratimi

Puna përgatitore

- Grumbullimi i të dhënave ekzistues dhe dokumentave të nevojshme për hartimin e PMPK
- Ndarja e ekonomisë pyjore në parcela dhe nënparcela
- Futja në SISP e planit të ri të mbarështimit dhe menaxhimi i procesit të punës
- Organizimi dhe menaxhimi i procesit të pjesëmarrjes së aktoreve lokal.

Puna në terren dhe përshkrimi parcelar

- Vizitat në terren.
- Hartimi i hartës paraprake dhe ndërtimi i rrjetit të sipërfaqeve provë
- Mjetet për punën e terrenit
- Puna ne terren.
- Puna në terren duhet të kryhet duke përdorur mjetet elektronike bashkohore si: GPS dhe tablet për grumbullimin e informacionit ne siperfaqet prove.
- Planifikimi inventarizimit dhe përshkrimi i rrjetit të siperfaqeve provë
- Metoda e inventarizimit dhe kampionimi për matjet e kullotave.
- Produktet pyjore jodrusore (bimët aromatiko-mjekësore, frutat pyjore, lulet, farat etj.)
- Futja e të dhenave dhe kontrolli.
- Të dhënat parcelare dhe lidhja me Kadastrën Pyjore dhe SISP.

Puna në zyrë/raportimi

Proçesi për hartimin e Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave duhet të respektojë standartet në mënyrë që të përftohen produkte finale homogjene (raporti, të dhënat, hartat etj) me qëllim përpunimin e të dhënave, transferimin e tyre në SISP dhe një koherencë me IKP. Pjesët e shkruara të raportit, tabelat dhe hartat duhet të jenë në përputhje me udhëzimet e dhëna në Udhezuesin për Planet e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019.

Raportimi.

Subjekti, pas lidhjes kontratës me Bashkin **Elbasan**, për hartimin e planit të mbarështimit të Ekonomisë Pyjore duhet të përgatisë dhe dorëzojë këto raporte:

- **Raporti fillestar**, i cili përgatitet pas përfundimit të hapit të parë lidhur me prezantimin e tij tek të gjithë palet e interesit, vizitat e para ne terren, krijimin e grupeve të punës, përcaktimin e metodologjisë për punën e terrenit përgatitjen e hartave sipas sistemit të ri koordinativ KRGJSH ku projekti me Shape File dhe LAYER e punuara në GIS të ngastrave pyjore dhe ndërtimin e rrjetit të sipërfaqeve provë në përputhje me kriteret teknike të udhëzuesit dorëzohen pranë strukturës së monitorimit. Ky raport duhet të dorëzohet brenda **90 ditëve** nga firmosja e kontratës.
- **Raporti Dytë** (Draft raporti planit mbarështimit) ky raport duhet të hartohet në përputhje me udhëzuesin në fuqi për hartimin e PMPK. Ky raport në këtë fazë të punës përmbledh të gjithë të dhënat e marra e grumbulluar nga matjet direkte në terren dhe përshkrimin e elementeve teknike të n/ngastrave të kësaj ekonomie pyjore (duhet të paraqitet brenda afateve kohore të shprehura ne planin e punës së paraqitur).
- **Raporti përfundimtar** paraqitet pas miratimit te PMPK, bazuar ne aktet ligjore në fuqi.

2.5 Përmbajtja e Planit të Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore

1. HYRJE

- 1.1. Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave (PMPK)
- 1.2. Ecuria e punës dhe përgjegjësitë
- 1.3. Metodologjia e Punës
- 1.4. Informacioni i përdorur në hartimin e PMPK

2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË

- 2.1. Informacioni i përgjithshëm rreth Ekonomisë pyjore
- 2.2. Pronësia, administrimi, organizimi
- 2.3. Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative
- 2.4. Konteksi i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore
- 2.5. Historiku i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave në Ekonominë Pyjore
- 2.6. Situata demografike dhe social-ekonomike
- 2.7. Marketingu i produkteve pyjore drusore dhe jodrusore
- 2.8. Gjuetia dhe peshkimi
- 2.9. Fasilitetet rekreacionale dhe didaktike
- 2.10. Prania e zonave të mbrojtura, specieve dhe stacioneve.

3. GJENDJA AKTUALE E PYJEVE DHE KULLOTAVE

- 3.1. Mbarështrimi dhe funksionet e Pyjeve dhe Kullotave
 - 3.1.1. Përdorimi i territorit (aktual & propozimet)
 - 3.1.2. Forma e qeverisjes (aktuale dhe propozimet)
 - 3.1.3. Ndarja e ekonomisë pyjore në parcela dhe nënparcela

4. KUSHTET STACIONALE

- 4.1. Klima
- 4.2. Topografia dhe morfologjia
- 4.3. Gjeologjia
- 4.4. Tokat
- 4.5. Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë
- 4.6. Erozioni në shpate dhe rrjedhiet ujore
- 4.7. Rrëshqitjet

5. VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI

- 5.1. Brezat bioklimatike
- 5.2. Pyjet dhe kullotat
- 5.3. Tipet e pyjeve

- 5.4. Tipet e kullotave
- 5.5. Tipet potenciale të vegjetacionit
- 5.6 Biodiversiteti
- 5.7. Prania e vlerave konservuese të larta (VKL)
- 5.8. Rreziqet për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin
- 5.9. Mundësitë për aktivitetet didaktike dhe kërkim shkencor

6. ANALIZA E PYJEVE DHE KULLOTAVE

- 6.1. Analiza e të dhenave për Pyjet
 - 6.1.1. Analiza e tipeve të pyjeve
 - 6.1.2. Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas formës së qeverisjes.
 - 6.1.3. Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimit
- Paraqitja në formë tabelare e të dhënave për secilën formë qeverisje në lidhje me:
 - sipërfaqen totale kundrejt klasave të moshës
 - volumin për hektar kundrejt klasës së moshës
 - sipërfaqen e specieve në raport me klasat e moshës
 - volumi i specieve kundrejt klasave të moshës
 - sipërfaqen totale për klasat e prodhimit
 - volumin total përklasaprodhimi
 - sipërfaqjasipasspecievekundrejtklasavetëprodhimit
 - voluminsipasspecievekundrejtklasavetëprodhimit
- 6.2. Analiza e të dhënave të kullotave
 - 6.2.1. Gjëndja e kullotave
 - 6.2.2 Madhësia e sipërfaqes së kullotave dhe vendodhja e tyre
 - 6.2.3. Altituda, pjerrësia, kundrejtimi, kushtet hidrologjike
 - 6.2.4. Mbritshmëria
 - 6.2.5 Grumbullimi i të dhenave për zonat e djegura në kullota (10 vitet e fundit)

7. REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

- 7.1 Rezultatet e Inventarizimit të Pyjeve
 - 7.1.1. Analiza statistikore e Inventarizimit
 - 7.1.2. Volumi dhe rritja në volum e grumbujve pyjorë
 - 7.1.3. Struktura Vertikale
 - 7.1.4. Cilësia e materialit drusor
 - 7.1.5. Biomasa dhe Faktorët e Ekspansionit të Biomassës
 - 7.1.6. Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekustrimin e karbonit
- 7.2. Gjëndja shëndetsore dhe fitosanitare
 - 7.2.1. Drurët e tharë
 - 7.2.2. Dëmtimet e tjera
- 7.3. Prerjet e paligjshme
 - 7.3.1 Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet në procesin e planifikimit
 - 7.3.2. Impakti i prerjeve ilegale në planifikimin dhe mbarështimin e pyjeve

- 7.4 Rezultatet e Inventarizimit të Kullotave
- 7.4.1. Tipi dhe cilësia e kullotave
- 7.4.2. Përdoruesit e kullotave dhe koha
- 7.4.3. Llojet e bagëtimeve
- 7.4.4. Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kullotave
- 7.4.5. Infrastruktura aktuale
- 7.4.6. Problemet mbi kullotjen dhe furnizimin e blegtorisë me bazë ushqimore

8. OBJEKTIVAT E MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

- 8.1. Objektivat e përgjithshme për planifikimin afat-gjatë
- 8.2. Objektivat kombëtare për Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave
- 8.3. Pajtueshmëria e PMPK me planifikimin rajonal dhe atë në nivel Bashkie
- 8.4. Objektivat kryesore të PMPK
- 8.5. Objektivat specifike të ekonomisë pyjore/NJM
- 8.5.1. Objektivat specifike mbi përdorimin e tokës, funksionin dhe formën e qeverisjes/menaxhimit.
- 8.5.2. Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve
- 8.5.3. Objektivat specifik silvikulturale
- 8.5.4. Objektivat specifik për kullotat
- 8.5.5. Objektivat specifik mbi biodiversitetin
- 8.5.6. Objektivat specifik mbi gjëndjeshëndetsore
- 8.5.7. Objektivat specifik mbi bifaunën
- 8.5.8. Objektivat specifik për pyjet me funksion prodhues
- 8.5.9. Objektivat specifik për pyjet me funksion mbrojtës
- 8.5.10. Objektivat specifik për pyjet me funksion rekreacioni
- 8.5.11. Objektivat specifik për pyjet me funksion konservues

9. MASAT/AKTIVITETET E PLANIFIKUARA NË KUADËR TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE.

- 9.1. Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit
- 9.2. Prerja vjetore silvikulturore
- 9.3. Planifikimi vjetor i masave
- 9.3.1. Masat në Pyje
- 9.3.2. Masat në kullota
- 9.3.3. Masat në infrastrukturë dhe në zonat e degraduara, rekreacionale dhe didaktike
- 9.4. Masat afat-gjata
- 9.4.1. Masat silvikulturale në trungishte
- 9.4.2. Masat silvikulturore në cungishte
- 9.4.3. Masat silvikulturore në shkurre
- 9.4.4. Pyllëzimi, ripyllëzimi
- 9.4.5. Masat në kullota
- 9.4.6. Gjëndja dhe masat në infrastrukturën e ekonomisë pyjore
- 9.4.7. Masat specifike për aktivitetet rekreacionale dhe didaktike

10. VLERËSIMI EKONOMIK

10.1. Vlerësimi i efekteve të masave të planifikuara në pyje dhe kullota

10.2 Planifikimi i të ardhurave/përfitimeve

10.3 Planifikimi i kostove/shpenzimeve

10.4 Analiza kosto-përfitim

2.6. Përgatitja e hartave

Me rëndësinë që kanë hartat tematike në procesin e planifikimit është e nevojshme që të përcaktohen:

- Tematika e hartave në përshtatje me kushtet e reja të territorit
- Elementet grafike standart, ngjyrat dhe emërtesat
- Dixhitalizimi i hartave dhe integrimi i tyre në sistemin GIS duke përdorur sistemin e ri zyrtar KRGJSH.

Hartat që do të përgatiten nga kontraktori në kuadër të planit të mbarështimit duhet të jenë të dixhitalizuara, të gjeoreferuara, me të gjitha elementët identifikues (kuota, rrjeti rrugor, rrjeti hidrik, emërtesat e vendeve, kufijtë e zonave të mbrojtura, izoipset kryesore etj) në shkallën 1:10 000 ose 1:25 000 (në varësi të madhësisë së sipërfaqes së ekonomisë pyjore). Hartat duhet të prodhohen nëpërmjet platformes së informacionit SISP.

Inventarizimi i grumbujve, metoda e punës për hartimin e Planit të Mbarështimit dhe specifikimet teknike të hartave do të zbatohen korrektësisht kërkesat në Manualin e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr.864 prot., datë 30.01.2019.

Plani i Mbarështimit i hartuar nga kontraktori së bashku me hartat pyjore dhe dokumentacioni shoqërues do të dorëzohen pranë autoritetit kontraktor në 4 kopje të printuara dhe 4 kopje në format elektronik (CD). Cilësia e materialeve që do të përdoren për printimin e planit të mbarështimit dhe hartave duhet të jete e katerorisë më të mirë të ofruar në treg. Hartat do të vishen me material plastik rezistues ndaj ujit.

Hartat duhet të realizohen në aplikacionin GIS, me izoipsa, dhe ato që do të përgatiten janë:

1. Harta e Ekonomisë Pyjore (parc/nëparcela).
2. Harta e Funksioneve.
3. Harta e tipeve të pyjeve, shkurreve dhe kullotave
4. Harta e rrjetit rrugor, infrastrukturës dhe sipërfaqeve të degraduara
5. Harta e ndërhyrjeve.
6. Harta ortofoto (ndarja parc/n/parcela).

3. AFATI I HARTIMIT TË PLANEVE TË MBARËSHTIMIT

Për realizimin e hartimit të Planit të Mbarështimit për këto ekonomi pyjore parashikohet një afat kohor **12 muhor**, që fillon me nënshkrimin e kontratës me subjektin e kontraktuar. Kontraktori duhet të parashikojë dhe të detajojë në mënyrë të saktë të gjitha fazat e punës së domosdoshme për arritjen e këtij qëllimi deri në momentin final, atë të miratimit dhe dorëzimit të produktit përfundimtar (*afati i miratimit mvaret nga institucioni i ngarkuar me ligj*).

Fazat që ndiqen për hartimin e Planit të Mbarështimit dhe afatet përkatëse, pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm:

| NR. | FAZAT E PLANIT TË MBARËSHTIMIT | MUAJT | | | | | | | | | | | | N | |
|------|---|-------|----|-----|----|---|----|-----|------|----|---|----|-----|---|--|
| | | I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII | | |
| 1. | Nënshkrimi i fillimit të punës, vlerësimin e aftësive të stafit . | | | | | | | | | | | | | | |
| 2. | Procesi i konsultimit me palët e interesuara dhe identifikimi qëllimeve dhe objektivave të PMPK | | | | | | | | | | | | | | |
| 3. | Puna përgatitore | | | | | | | | | | | | | | |
| 3.1. | Trajnimiti i ekipit | | | | | | | | | | | | | | |
| 3.2. | Grumbullimi i dokumentave të nevojshme | | | | | | | | | | | | | | |
| 3.3. | Drafti i hartës pyjore (ndarja parcelare dhe rrethet e sipërfaqeve provë) | | | | | | | | | | | | | | |
| 4. | Puna e terrenit (të dhënat bazë) | | | | | | | | | | | | | | |
| 4.1. | Përgatitja e punës së terrenit | | | | | | | | | | | | | | |
| 4.2. | Përshkrimi i parcelar | | | | | | | | | | | | | | |
| 4.3. | Inventarizimi i pyjeve dhe kullotave | | | | | | | | | | | | | | |
| 4.4. | Rekomandimet për mbarshtimin (objektivat dhe masat) | | | | | | | | | | | | | | |
| 5. | Raportimi i të dhënave dhe planifikimi i aktiviteteve | | | | | | | | | | | | | | |
| 5.1. | Përgatitja e Raportit | | | | | | | | | | | | | | |
| 5.2. | Përgatitja e Hartës | | | | | | | | | | | | | | |
| 5.3. | Planifikimi i vjetor ndërhyrjeve/aktiviteteve | | | | | | | | | | | | | | |
| 5.4. | Vlerësimi ekonomik | | | | | | | | | | | | | | |
| 6. | PMPK dhe SISP | | | | | | | | | | | | | | |
| 6.1. | Futja, trajnimi, grumbullimi i të dhënave dhe hartave etj. | | | | | | | | | | | | | | |
| 6.2. | Përshkrimi i parcelar (të dhëna nga SISP dhe sipërfaqet provë etj.) | | | | | | | | | | | | | | |
| 6.3. | Ngarkimi i raportit, planifikimi i vjetor, hartat etj. | | | | | | | | | | | | | | |
| 6.4. | Procesi i validimit të PMPK në SISP | | | | | | | | | | | | | | |
| 6.5. | Miratimi i PMPK | | | | | | | | | | | | | | |

4. MONITORIMI I FAZAVE TË HARTIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Autoriteti kontraktor do të monitorojë fazat e ndryshme të hartimit të Planit të Mbarështimit dhe punimet që realizohen nga subjekti kontraktor nëpërmjet grupit të monitorimit që do të ngihet me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor.

Grupi i monitorimit do të ketë në përbërje 2-3 specialistë të pyjeve (inxhinier pyjesh me përvojë në këtë fushë) nga strukturat përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave pranë Bashkisë Elbasan, të cilët do të monitorojnë procesin e hartimit të Planit të Mbarështimit nga subjekti i kontraktuar në lidhje me:

- Zbatimin e detyrimeve kontraktuale në përgjithësi.
- Përmbushjen e kërkesave dhe kriterëve teknikë të manualit të mbarështimit të pyjeve ne fuqi për punimet e terrenit dhe ato të zyrës.
- Zbatimin e detyrimeve kontraktuale në lidhje me numrin e punonjësve dhe kualifikimet profesionale të stafit të përfshirë në proces nga kontraktori.
- Respektimin e kriterëve tekniko-ligjore nga kontraktori gjatë procesit të hartimit të Planit të Mbarështimit.
- Zbatimin e afateve kohore për realizimin e fazave dhe aktiviteteve nga kontraktori të përcaktuara paraprakisht.
- Detyrime të tjera të kontraktorit.

Grupi i monitorimit gjatë realizimit të detyrave të ngarkuara, njofton me shkrim titullarin zyrtar, në lidhje me problematikat që konstaton gjatë procesit të hartimit të Planit të Mbarështimit si dhe sugjeron masat e nevojshme për zgjidhjen e problemeve dhe zbatimin e detyrimeve kontraktuale dhe tekniko-ligjore nga ana e kontraktorit. Grupi i monitorimit në përfundim të çdo faze harton raportin e monitorimit dhe sëbashku me situacionin e punimeve të realizuara nga kontraktori ja paraqet zyrës së financës për efekt pagese. Grupi i monitorimit bën dhe reçensimin e Draft Planit të Mbarështimit pasi është paraqitur nga kontraktori dhe ja paraqet organeve eprorë, për miratim sipas ligjit.

5. MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Draft Plani i Mbarështimit të ekonomisë pyjore i hartuar nga kontraktori, pasi ti nënshtrohet konsultimit me aktorët lokal (Nj.Administrative, shoqatat e pyjeve, komuniteti lokal, bashkia etj) dhe reçensimit, merr në shqyrtim dhe reflekton te gjitha vrejtjet dhe rekomandimet e bera nga aktoret e sipërpërmendur. Draft plani i Mbarështimit të ekonomisë pyjore me ndryshimet dhe reflektimet e bëra pas reçensimit i kalon për miratim strukturave të përcaktuara sipas akteve ligjore ne fuqi.

6. REFERENCA LIGJORE

Gjatë hartimit të këtij projekti janë mbajtur në konsideratë detyrimet që lindin nga kuadri ligjor në fuqi në fushën e menaxhimit të pyjeve dhe në fushën e prokurimit publik.

Kuadri ligjor përkatës përbëhet nga:

- Ligji Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet”;
- Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.1014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 433, date 08.06.2016 për “Transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/ Bashkive”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 361, datë 12.05.2010, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullor publik”;
- Manualin e Mbarështimit të Integruar të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019;
- Vendimin e Këshillit Bashkiak Elbasan nr. 190, datë 27.12.2022 “Miratimi i Buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2023”.

7. FONDI LIMIT PËR HARTIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTIMIT

Bashkia e Elbasan me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor për hartimin e planeve të reja të mbarështimit të fondit pyjor që ka në pronësi të sajë, ka planifikuar mjetet financiare për kryerjen e studimit për hartimin e Planit të Mbarështimit për ekonominë pyjore “**Polis-Vasjan**”.

Në përputhje me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi, për prokurimin publik, nga ana e autoritetit kontraktor është realizuar përlogaritja e fondit limit që do të përdoret për kontraktimin e subjektit që do të hartojë planin e mbarështimit të ekonomisë/ve pyjore sipërpërmendur.

Përlogaritja e fondit limit e planifikuar për hartimin e planeve të mbarështimit për këtë ekonomi pyjore është realizuar duke u referuar në VKM-në nr. 361, datë 12.05.2010, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullor publik”, Manualin e Mbarështimit të Integruar të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr.864 prot, datë 30.01.2019.

- Fondi limit, për hartimin e planit të mbarështimit, për ekonominë pyjore “**Polis-Vasjan**”, bazuar në preventivin bashkangjitur është:
- Vlera pa TVSH = **9,773,100** (nëntë milion e shtatëdhjet e tre mijë e njëqind) Lekë.